

METODOLOGJIA E SHËRBIMEVE

OBJEKTI: Shërbimi i Pastrimit dhe Largimit të Mbetjeve Urbane për Bashkinë Maliq

I. Fshirja e Rrugëve dhe Trotuareve me Krahë.

1.1 Volumet e punimeve

Autoriteti Kontrator ka parashikuar fshirjen me fshese dore e te gjitha rrugeve te shtruara me siperfaqe totale prej 178 612 m², do të realizohet si më poshtë :

- Fshirja me fshesë dore e qytetit Maliq me nje siperfaqe prej 88.362 m² do te fshihet çdo ditë nga 14 punonjës. Ndersa per rruget e tjera te fshatrave te njesive administrative perreth, me nje siperfaqe prej 90.250 m², do te fshihen me dore, përkatesisht ne Nj.Administrative Libonik 18750 m², nga 2 punonjës , në Nj.Administrative Pojan 27000 m³ nga 3 punonjës, në Nj.Administrative Pirg 25200 m² nga tre punonjës dhe ne NJ.Administrative Vreshtas 19300 m² nga 2 punonjës do te fshihen çdo dy ditë, pra nje dite Po dhe nje dite Jo . (Sipas hartës se rrugëve që do të fshihen me fshesë dore)

1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Sherbimi i fshirjes se rrugeve dhe trotuareve me krahe konsiston ne :

- a. Fshirjen me punetore me fshese te gjithe rrugeve kryesore , shesheve dhe rrugeve dytesore, duke mbuluar siperfaqen e plote te trotuarit si dhe siperfaqen e plote rruge + trotuar.
- b. Te gjitha rruget gerryhen (*ne qofte se eshte e nevojshme*), fshihen dhe te gjitha mbeturinat pasi grumbullohen, transportohen me karroca dore per tek kontenieri me i afert.
- c. Mbeturinat te cilat grumbullohen nga pastrimi me fshese dore, ne asnje menyre nuk duhet te hidhen ne kunetat e ujrave te bardha. Per cdo rast konstatimi, Autoriteti Kontrator merr masa me gjobe ose ndalesa.
- d. Gjate dites, operatori i sherbimit duhet te mobilizojë nje numer te caktuar punetoresh per pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve te hedhura randomte ne rruge, trotuare dhe sheshe. Keta punetore duhet te levizin pergjate gjithe siperfaqes objekt pastrimi me qellim qe te grumbullojne dhe me pas te depozitojne keto papasterti ne kontenierin me te afert.
- e. Puntoret qe kryejne kete proces pune duhet te pajisen me uniformen perkatese verore apo dimerore, uniforme ne dite shiu, cizme dhe doreza pune.
- f. Veglat apo mjetet qe nevojiten per kryerjen e ketij sherbimi jane fshese ,farashke, karroce dore, lopate.

1.3 Plani i punes dhe grafiket e punimeve.

- a. Grafiket e punimeve per realizimin e sherbimit te pastrimit te zones, pergatiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti Kontraktor.Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit , sa here lind e nevojshme edhe brenda nje viti , vetem per shkak te pamundesise se kryerjes apo ne rastet e ndryshimit te parkimit te makinave per rruge te vecanta dhe dite te vecanta dhe gjithmone pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti Kontrator .
- b. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte :
 - Oraret e operimit ne secilen rruge dhe trotuar. Orari i pranuar 05:00 – 08:00.
 - Numri i punetoreve qe do te punojne ne cdo operacion punimesh.
- c. Grafiket e punimeve do te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

- d. Autoriteti Kontrator ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate si dhe per te vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa per mos permbushjen e tyre.

1.4 Rregulla per t'u zbatuar

- a. Operatori i sherbimit duhet te mbaje paster cdo siperfaqe rruge dhe trotuari ne perputhje me rregulloren
- b. Per asnje rast nuk do te lejohen rruge te papastruara apo mbeturina te palarguara ne to. Ne te gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktore te jashtem te cilat nuk mund te pastrohen me operacionet e parashikuara ne metodologji, operatori i sherbimit duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per pastrimin e tyre jo me vone se 3 ore nga orari i perfundimit te sherbimit i percaktuar ne grafik. Ne rast te kundert pergjegjesia eshte e operatorit te sherbimit dhe do te penalizohet sipas parashikimit te nenit 37 te Ligjit Nr.8094 , date 21.03.1996 “ Per largimin publik te mbetjeve”
- c. Operatori i sherbimit duhet te kete ne eficence nje “Zyre te Kontaktimit “ per marrjen e ankesave e cila duhet te jete e hapur net e gjithe ditet e javes nga ora 7.00-20.00.Perfaqesues te operatorit te sherbimit duhet te jene prezent gjate gjithe kohes se parashikuar per te marre verejtjet e qytetareve dhe Autoritetit Kontrator dhe per t'u dhene zgjidhje problemeve te prezantuara brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit.
- d. Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite ne pune minimalisht numrin e punetoreve dhe pajisjeve sipas numrit te deklaruar ne oferten e tenderit per te garantuar kryerjen me cilesi dhe ne kohe te sherbimit.
- e. Per raste te vecanta operatori i sherbimit eshte i detyruar te fshije rruget me shume se nje here pa shpenzime.
- f. Gjate procesit te fshirjes i ndalohej kategorikisht hedhja e mbeturinave ne pusetat e elektrikut, telefonise, te ujesjellesit , ujrave te zeza, ne zgarat e pusetave te ujrave atmosferike , ne shtreterit e ujrave rrjedhese, zonat e gjelberta , etj. Ne rast te konstatimit te kesaj dukurie operatori i sherbimit detyrohet t'i pastroje menjehere. Ne rast te perseritjes apo mospastrim te tyre brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit , pervec pergjegjesise se mbartjes se shpenzimeve perballat me penalitete sipas kontrates dhe ligjeve e vendimeve ne fuqi per ndotjen e shkaktuar.si Ligji Nr.10431 , datë 09.06.2011 „ Për mbrojtjen e mjedisit ,,
- g. Perdorimi i uniformave per punetoret eshte rigorozisht i detyrueshem dhe do te merren sanksione per mosplotesim te tyre.

1.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i sherbimit duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrave kontraktuale te fshirjes me krahe te rrugeve dhe trotuareve si dhe te gjitha sherbimeve plotesuese te percaktuara me lart , keto mjete dhe pajisje :

- a. Cdo punetor duhet te jete i pajisur me uniforme dhe me mjete pune pastrimi si fshesa, karroca dore , lopata , kaci,etj per te mundesuar kryerjen me cilesi te sherbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punes te mbahen ne gjendje te paster dhe te mire. Punetoret e fshirjes duhet te jene te pajisur me fshese , lopata, dhe karroca dore.

II. Fshirja e rrugëve dhe fshesë mekanike

2.1 Volumet e punimeve

Autoriteti Kontrator ka parashikuar fshirjen me fshesë mekanike të një sipërfaqeje prej 4000 m² një herë në 10 ditë (*tre herë në muaj*), e cila do të realizohet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor në bulevardin kryesor të qytetit Maliq apo në rrugë të tjera kryesore në Njësitë Administrative . Sipërfaqja që do të fshihet me fshesë mekanike për atë ditë do të zbritet nga sipërfaqja që fshihet me fshesë dore .

2.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Sherbimi i fshirjes se rrugeve me fshesë mekanike konsiston ne :

- Pastrimin e segmenteve anësore të rrugeve kryesore te cilat jane të pajisura me kuneta dhe bordura anësore .
- Pastrimi rrugeve me fshesë mekanike nuk do te sjelle ndotje te ambientit dhe të mjedisit si pluhura apo grimca pluhur
- Pastrimi me fshesë mekanike do te behet në ato segmente qe nuk jane te bllokuara nga parkimi i mjeteve

2.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve.

- a. Plani i punës për shërbimin e pastrimit me fshesë mekanike do te jepet nga ana e Autoritetit Kontrator ne momentin e lidhjes së kontratës.
- c. Grafiku i punimeve per realizimin e shërbimit te pastrimit me fshesë mekanike , pergatitet nga sipermarresi (tre herë në muaj) dhe miratohen nga Autoriteti Kontrator . Ky grafik mund te pesoje ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te shërbimit , sa here lind e nevojshme apo vetem per shkak te pamundesise se kryerjes apo ne rastet e ndryshimit te parkimit te makinave per rruge te vecanta dhe dite te vecanta dhe gjithmone pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues.
- d. Autoriteti Kontrator ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e shërbimit te sipërpermendur, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate si dhe per te vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa per mos permbushjen e tyre sipas pikave te kontrates .

2.4 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrave kontraktuale te fshirjes me fshesë mekanike, keto mjete dhe pajisje :

- a. Mjetin , autofshesë mekanike të pajisur me tre fshesa , dy anësore dhe nje përpara , me kontinjerin për mbledhjen e mbeturinave të fshira , me depozitën e ujit dhe filtrat përkatës për të mos shpërndarë pluhur dhe grimca pluhuri me amjentet dhe mjediset perreth .
- b. Shoferi i mjetit duhet të jetë me uniformën e Operatorit të shërbimit, per te mundesuar kryerjen me cilesi te shërbimit.

III.Mbledhja dhe transportimi i mbetjeve urbane

3.1.Volumet e punimeve

- Autoriteti Kontraktor ka parashikuar ,mbi numurin e banoreve dhe normativa e gjenerimit te mbetjeve per banor ,numrin e kontinjerëve , volumet dhe specifikimet e tyre per secilen pike grumbullimi mbeturinash(PGM) ne zonen e kontrates.

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar që grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane për në landfill do të realizohet :

Sasia ditore për Njësinë Qëndër Maliq është 3.3 ton/dite , që do largohen çdo dite me kamion 5 Ton dhe çdo mjet do te kete perveç shoferit edhe dy punonjes .

Sasia ditore për Njësinë Administrative Libonik është 5 ton/dite , që do largohen çdo dite me kamion 7 Ton dhe çdo mjet do te kete perveç shoferit edhe dy punonjes .

Sasia ditore për Njësinë Administrative Pojan është 5.4 ton/dite , që do largohen çdo dite me kamion 7 Ton dhe çdo mjet do te kete perveç shoferit edhe dy punonjes .

Sasia ditore për Njësinë Administrative Pirg është 3.5 ton/dite , që do largohen çdo dite me kamion 5 Ton dhe çdo mjet do te kete perveç shoferit edhe dy punonjes .

Sasia ditore për Njësinë Administrative Vreshtas është 3.1 ton/dite , që do largohen çdo dy dite me kamion 7 Ton dhe çdo mjet do te kete perveç shoferit edhe dy punonjes .

- Keshu sipermarsi duhet te kryje sherbimin e plote te parashikuar ne metodologji per cdo dite per : **331 konteniereve**, me volum 1.1 m³, ne qytetin Maliq dhe ne njesite administrative perreth qe do te zbrazen cdo dite. Gjithashtu sipermarresi do te beje mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave te te gjithë bizneseve te Bashkise Maliq (*shpërndarja e kontinjereve sipas hartave bashkëngjitur*) .

3.2 Specifikime teknike dhe metodologjia.

Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit te mbetjeve te ngurta urbane konsiston ne :

- a. Grumbullimin e mbetjeve nga çdo kontenier me makina të pershtatshme teknologjike te percaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave te hedhura perreth ne nje distance me rreze 10 m nga cdo pike grumbullimi , si dhe rivendosja e konteniereve te sistemuar ne vendin e caktuar. Kontenieret duhet te vendosen drejt , ne pozicion vertikal dhe ne menyre estetike per mjedisin urban dhe me kapake te mbyllur. Me pas makinat teknologjike kryejne transportin e mbeturinave ne venddepozitimit te tyre (Landfill).

3.3 Plani i Vendosjes se Kontenierve dhe Grafiket e Punimeve.

a. Autoriteti Kontraktor ka percaktuar ne fillim te kesaj kontrate pikat ekzakte te grumbullimit te mbetjeve urbane dhe numrin e kazaneve per secilen pike ne te gjithë zonen e kontraktuar, sipas hartave bashkëngjitur .

b. Grafiku vjetor i realizimit te sherbimit te pastrimit, pergatitet nga operatori i sherbimit dhe miratohet nga Autoritet Kontraktor . Keta grafike mund te pesojne ndryshime edhe brenda vitit nese lind e nevojshme me propozim te operatorit te sherbimit ose nga autoriteti kontraktues per permiresimin e sherbimit dhe mire organizimit te tij, ose si rezultat i ndryshimeve qe mund te ndodhin ne infrastrukture gjithmone pas kerkeses se njerës pale dhe behen te zbatueshme pas miratimit te Autoritetit Kontraktor .

Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte :

- *. Oraret e operimit ne secilen pike kontenieresh .
- *. Llojin ,targen dhe itinerarin e makinave teknologjike qe do te kryejne sherbimin.
- *. Oraret e operimit dhe mjetet per sherbimet mbeshtetese.
- *. Numrin e puntoreve qe do te mbeshtetin cdo operacion punimesh.

Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

c. Autoriteti Kontraktor ka te drejte, ne cdo kohe, te inspektoje kryerjen e sherbimeve te siper permendura konform standarteve, rregullave dhe cilesise se kerkuar ne kete kontrate. Ne rast mospermbushje te detyrimeve kontraktore, Autoriteti Kontraktor ka te drejte vendosjen e ndalesave, penaliteteve apo gjobave sipas pikave te kontrates .

- a. per mos permbushjen e tyre sipas pikave te kontrates .

3.4 Rregulla per t'u zbatuar

- a. Operatori i sherbimit duhet te mbaje paster piken e grumbullimit te mbeturinave (PGM) sic percaktohet ne keto specifikime teknike
- b. Per asnje rast nuk do te lejohen kazanet e tejmbushur me mbeturina, te pa transportuara dhe mbeturinat e lena ne zonen perreth konteniereve. Ne te gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktoret e jashtem, operatori i sherbimit duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per pastrimin e tyre jo me vone se 3 ore nga orari i perfundimit te sherbimit, i percaktuar ne grafik. Ne rast te kundert pergjegjesia eshte e operatorit te sherbimit dhe do te vendosen penalitete sipas parashikimit ne nenin 37 te Ligjit Nr.8094 , date 21.03.1996 “ *Per largimin publik te mbetjeve* “
- c. Operatori i sherbimit ka per detyre te kryeje grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane qe depozitohen ne ambjente publike brenda zones se kontraktuar edhe ne rast se hidhen larg pikave te miratuara te grumbullimit te tyre. Ne rastet kur mbetjet hidhen ne menyre te perseritur operatori I sherbimit ka te drejete te kerkoje miratimin e vendosjes se konteniereve dhe perfshirjen e tyre ne grafikun e punimeve.
- d. Operatori i sherbimit duhet te informoje me shkrim Autoritetin Kontraktor ne menyre periodike per te gjitha kontratat private te pastrimit qe do te kete me te trete , te reklamoje numrin e mjeteve dhe puntoreve shtese per keto sherbime per te garantuar cilesine e kerkuar te sherbimeve ne kontraten me Autoritetin Kontraktor.
- e. Operatori i sherbimit duhet te kete ne eficence nje“ Zyret e Kontaktimit “per marrjen e ankesave e cila duhet te jete e hapur ne te gjitha ditet e javes nga ora 7.00-20.00. Perfaqesues te operatorit te sherbimit duhet te jene present gjate gjitha kohes se parashikuar per te marre verejtjet e qytetareve dhe Autoritetit Kontraktor dhe per t'u dhene zgjidhje problemeve te prezantuara brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit.
- f. Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite(ose nate) ne pune , minimalisht numrin e kerkuar te makinerive, pajisjeve.
- g. Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite ne pune minimalisht numrin e puntoreve te transportit dhe shofereve sipas numrit te deklaruar ne oferten e tenderit per te garantuar kryerjen me cilesi dhe ne kohe te sherbimit.
- h. Mbeturinat si: material ndertimi ,plastike peme (te krasitura) orendi shtepiake etj qe nuk hidhen brenda kontenierit po rreth tij e ne ambiente te tjera duhet te evadohen nga operatori i sherbimit .
- i. Ne asnje rast nuk duhet te kryhet largimi i mbetjeve urbane pa mbaruar pastrimi me fshese i akseve te rrugeve. Ne rast te kundert, operatori i sherbimit duhet te ribeje zbrazjen e konteniereve brenda orarit te percaktuar me siper.
- j. Operatori i sherbimit ne asnje rast nuk duhet te lejoje renien nga mjetet teknologjike te mbeturinave e sapombledhura. Ne rast se shfaqen problematika te tilla, operatori i sherbimit menjehere duhet te mbledhe mbeturinat e rena, pastroje dhe disifektoje siperfaqen e ndotur prej tyre.
- k. Perdorimi i uniformave per punetoret qe kryejne sherbimin e pastrimit eshte rigorozisht i detyrueshem

3.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i sherbimit duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrimeve kontratuale (mbledhjes, transportit, largimit te mbeturinave) dhe te gjitha Sherbimeve Plotesuese te percaktuara me lart , keto mjete dhe pajisje :

Konteniere per mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave respektivisht si me poshte:

- 311 konteniere metalike, me kapacitet 1.1 m³. Kontenieret duhet te jene ne gjendje te rregullt, me kapak metalik , te lyer me te njejten ngjyre dhe te paisur me rrota,per levizjen sa me te lehte te tyre.
- Kontinjeret jane të shperndare ne Njesine qender (Maliq) , fshatin Maliq dhe fshatin Kolanec 70 cope , në Njesine Administrative Libonik 73 cope , ne Njesine Administrative Pojan 84 cope. Njesine Administrative Pirc 44 cope dhe në Njesine Administrative Vreshtas 60 cope

- Operatori i shërbimit mund të shtojë numrin e kontenierëve kundrejt kërkesës zyrtare të Bashkisë në përputhje me kërkesat dhe vëllimet për gjatë kohëzgjatjes të kontratës.

Makina të nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë :

- Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor, për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtës jo më pak se 7 ton, cope 3 (tre), me dokumentacion të rregullt për qarkullim,
- Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 5 ton, 2(dy) copë dhe me dokumentacion të rregullt për qarkullim.
- Të gjitha makineritë teknologjike që do të përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë të pastra dhe në gjendje të mirë pune .

3.6 Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

- a. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë, por jo më pak se një herë në gjashtë muaj nga Autoriteti Kontrator për gjendjen e gatishmerisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuar nga Autoriteti Kontrator. Ato duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të rregullt. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të këmbimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmerisë së mjeteve.
- c. Automjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dizinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d. Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen pastër, në gjendje të mirë teknike. Në rast demtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe demtime të rrotave ose kapakeve, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjienik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori i shërbimit merr përsipër riparimin e të gjitha demtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit, brenda 3 ditëve nga momenti i konstatimit të demtimit. Në rast të mosriparimit të plote të kontenierëve, ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete sipas nenit 37 të ligjit Nr.8094, datë 21.03.1996 „ Për largimin publik të mbetjeve „,
- e. Operatori i shërbimit duhet të verë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave .
- f. Detyrimisht në të gjitha makinat dhe kontenierët duhet të shkruhet “ Për një Qytet më të pastër”, emri i firmës si dhe numri i telefonit të shërbimit 24 orësh të firmës.

IV.Larja speciale e rrugëve

4.1 Volumet e punimeve

Autoriteti Kontrator ka parashikuar paraprakisht sheshet ,rrugët dhe sipërfaqet e tyre në të cilat do të kryhet shërbimi i larjes speciale të rrugëve për të gjithë zonën e kontratuar sipas listës së rrugëve dhe vëllimet e tyre për shërbimin e larjes speciale periodike.

Operatori i shërbimit do të kryejë larjen speciale me presion të rrugëve si shërbim 92 ditë në vit në një sipërfaqe prej 23,515 m² sipas metodologjisë së përcaktuar në zonën që do të kontratohet. Periudha e larjes speciale të rrugëve do të jetë 01 Qershor deri 31 Gusht 1 herë në ditë.

Qëllimi i këtij shërbimi special është pastrimi total i baltes apo pluhurit që mund të mbetet përgjatë sipërfaqes së rrugës pas kryerjes së shërbimit të fshirjes me makineri, pra eliminimi total i ndotjes nga pluhuri dhe balta.

4.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

- a) Grafiku i larjes dhe orari hartohet nga operatori i shërbimit, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor dhe miratohet nga Autoriteti Kontraktor .
- b. Freskimi dhe larja me presion e rrugeve do të kryhet me mjet tip autobot i cili të ketë pajisje për të hedhur ujë me presion dhe uji që do të përdoret të jetë i pastër.
- c. Në rastet kur ky proces nuk kryhet për arsye objektive si shiu apo bora atëherë behen ndalesa.
- d. Operatori i shërbimit në fillim të çdo viti duhet të garantojë burimet e furnizimit me ujë të pastër.
- e. Larja e bulevardit kryesor të qytetit nga urra në hyrje të Maliqit deri tek rrethrotullimi në Libonik së bashku me sheshin Puntori në Maliq do të kryhet nga makineri e pajisur me furca teli të bute, të cilat janë të posaçme për larjen e rrugëve . Larja me presion do të bëhet me ujë dhe detergjent të posaçëm për larje .

4.3 Plani i punës dhe grafiku i punimeve

1. Larja speciale e rrugëve do të bëhet çdo ditë gjatë periudhës të mesipërme, gjithmone pas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve
2. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të larjes speciale të rrugëve përgatiten nga sipërmarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti Kontraktues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit sa herë që lind e nevojshme edhe brenda një viti , vetëm pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktues këto ndryshime.
3. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
4. Operatori i shërbimit duhet të rakordojë sipas grafikut të punimeve duke përfunduar me pare procesin e plote të fshirjes për rrugët mbi të cilat do të kryhet larja speciale dhe duke kryer pas përfundimit të këtij shërbimi.
5. Operatori i shërbimit do të kryejë larjen speciale të rrugëve sipas listës së rrugëve dhe vëllimeve të përcaktuara si dhe hartës treguese bashkëngjitur kësaj kontrate.
6. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipërmendura , respektimin e standarteve të kerkuara , rregullave dhe cilësive së kerkuar nga kjo kontrate dhe për të vendosur penaltete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre sipas pikave të kontratës .

4.4 Rregulla për t'u zbatuar

1. Autoriteti kontraktues do të inspektojë gjatë ose pas përfundimit të shërbimit për të siguruar rigorozisht efektivitetin e këtij shërbimi dhe cilësive e kerkuar.
2. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme e kryerja e shërbimit të larjes speciale për shkak të kushteve atmosferike si shi apo debore , operatori i shërbimit nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.
3. Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor do të shënojnë në procesverbalet ditore dhe mujore të gjitha ditët dhe vëllimet përkatëse që për shkak të rreshjeve nuk është kryer shërbimi i larjes speciale.
4. Do të konsiderohet i pavlefshëm kryerja e këtij shërbimi në kushtet e rreshjeve atmosferiket e përshkruara me sipër. Do të bëhet përjashtim vetëm për rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti Kontraktues për shkak të ndryshme.

5. Te gjitha shpenzimet per ujin qe do te perdoret per larjen speciale do te mbarten nga operatori i sherbimit.

4.5 Mjetet dhe pajisjet per larjen speciale te rrugeve

Operatori i sherbimit duhet te siguroje per realizimin e larjes me presion te rrugeve sipas percaktimeve te kontrates , te gjitha punimet , materialet , pajisjet si dhe lejet perkatese.

1. Operatori i sherbimit duhet te vere ne dispozicion dhe te perdore per plotesimin e detyrave kontraktuale te sherbimit te larjes speciale te rrugeve keto mjete :
 - Makine per larjen e rrugeve (autobot) te pajisura me pompe per larjen e rrugeve me presion , pajisur me tub per nxjerrjen e ujit me presion ne pjesen ansore te tij me kapacitet mbajtes jo me pak se 5000 litra uje , jo me pak se 1 cope. Te jete konform standarteve dhe normave teknike te Komunitetit Europian.
2. Automjeti qe do te perdoret per larjen speciale te rrugeve, mund te kontrollohet ne cdo kohe, por jo me pak se njehere ne gjashte muaj nga Autoriteti Kontrator per gjendjen e gatishmerise dhe inventarizimin e tyre.
3. Automjeti per larjen e rrugeve duhet te mbahet pastër dhe ne gjendje të mire pune , të jete me logon e Operatorit të sherbimit .

V. Larja dhe dizifektimi i konteniereve

5.1 Volumet e punimeve

Operatori i sherbimit do te dizifektojë 331 konteniere me volum 1.1 m^3 .

5.2 Metodologjia

- a. Operatori i sherbimit do te grumbulloje dhe transportoje kontenieret cdo nate ne autoparkun e tij dhe te kryeje larjen e plote dhe dizifektimin e tyre atje. Kontenieret do te largohen detyrimisht pas zbrazjes se plote te tyre.
- b. Per te mundesuar kryerjen e ketij sherbimi operatori i sherbimit do te kete ne dispozicion nje numer te nevojshem konteniresh reserve per te zevendesuar cdo nate kontenieret e larguar per t'u lare.
- c. Kontenieret per mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashte me uje me presion ,
- d. Me sherbim dizifektimi kuptojme realizimin e sherbimit te dizifektimit dhe deratizimit te te gjithë siperfaqes se jashtme dhe te brendshme te kontenierit.
- e. Dizifektimi i kontenierve behet , e 95% pluhurgelqereje me 5 % permbajtje klori , brenda cdo kazani. Te gjithë kontenieret duhet te jene te rregullt dhe te gatshem per pune Ne rast demtimi ato duhet te largohen menjehere per tu riparuar dhe te zevendesohen me te tjere ne gjendje pune

5.3 Grafiket e punimeve

- a. Grafiket e punimeve per transportin, larjen dhe dizifektimin e konteniereve , pergatiten nga operatori i sherbimit dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontratues.
- b. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit , i cili nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut.
- c. Autoriteti Kontrator ka te drejte te inspektojë ne cdo kohe dhe ne perfundim vendet e grumbullimit te mbeturinave per te pare kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standarteve te

kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur penalitete , gjoba dhe ndalesa per mospermbushjen e tyre , sipas pikave te kontrates .

5.4 Mjetet dhe pajisjet

- a. Lende dizifektuese per dizifektimin e konteniereve.
- b. Operatori i sherbimit duhet te kete te instaluar ne autoparkun e tij depozite uji si dhe mjete pune (pompe dhe pistolete uji) per larjen me presion dhe dizifektimin e konteniereve.
- c. Nje sasi e konsiderueshme e pjeseve te kembimit duhet te mbahet gati per te siguruar plotesimin ne kohe dhe te vazhdueshem te kontrates.

VI. Mirëmbajtje sipërfaqe të gjelberta

6.1 Volumet e punimeve

- a) Autoriteti Kontratues ka parashikuar paraprakisht siperfaqet e gjelberta ne te cilat do te kryhet sherbimi i mirmbajtjes së tyre. Qellimi i ketij sherbimi eshte mirëmbajtjen e lulishteve , parqeve dhe të pemeve ne nje siperfaqe prej 16400 m² kryesisht ne lulishtet e qytetit të Maliqit dhe në rrethrotullimi Libonik. Fuqia puntore për këtë shërbim është parashikuar 6 punonjës .
- b) Ky sherbim konsiston në pastrimin e rrugicave të sipërfaqeve të gjelberta , punimin e tokes , shkrifterimin dhe nivelimin e tokes , pleherimin me plehra kimike dy here në vit , mbjelljen e fidanave te luleve , ujitjen e tyre , si dhe 20 kositje të barit aty ku nuk ka lule .
(bashkengjitur harta e shperndarjes së lulishteve të cilat do te mirembahen)

6.2 Metodologjia

Sherbimi i mirmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberta konsiston ne :

- a. Pastrimin e rrugicave të sipërfaqeve të gjelberta, fshirjen me fshese te gjithë rrugicave dhe mbajtjen paster te tyre .
- b. Te gjitha siperfaqet e lulishteve do te punohen me bel, ne thellesi jo me pak se 25 cm , do te shkrifterohen dhe nivelohen dy here ne vit. Gjithashtu do te punohet me bel dhe siperfaqja e tokes perreth pemeve dhe shkureve dekorative ne nje diameter 1 m.
- c. Siperfaqja e tokes do te do te pasurohet me plehra kimike jo me pak se dy here ne vit
- d. Ne pjesen e tokes se punuar do te mbillen filiza lulesh shume ngjyreshe .
- e. E gjithë siperfaqja prej 16400 m² do te vaditet sipas nevojës per ta patur gjithmone te lulezuar dhe te gjelberuar .
- f. Shkuret dekorative do te krastiten vazhdimisht duke ju dhene forma dhe konfigurime te ndryshme .
- g. Pjesa tjeter e siperfaqes qe nuk do te mbillet me lule dhe do te jete e mbjelle me bar do te kositet minimumi 20 kositje ne vit
- h. Gjate dites, operatori i sherbimit duhet te mobilizojë nje numer te caktuar punetoresh per kete sherbim .
- i. Puntoret qe kryejne kete proces pune duhet te pajisen me uniformen perkatese me logon e Operatorit te sherbimit
- j. Veglat apo mjetet qe nevojiten per kryerjen e ketij sherbimi jane bel, prashajke, gershere, motokorse .

6.3 Plani i punes dhe grafiket e punimeve.

- a) Grafiket e punimeve per realizimin e sherbimit te mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta , perгатiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti Kontratues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne

oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit , sa here lind e nevojshme edhe brenda nje viti , vetem per shkak te pamundesise se kryerjes

- b) Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte :
 - Oraret e operimit ne secilen lulishte apo park lulishte
 - Numri i punetoreve qe do te punojne ne cdo operacion punimesh.
- c) Grafiket e punimeve do te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- d) Autoriteti Kontratues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate si dhe per te vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa per mos permbushjen e tyre sipas pikave te kontrates .

6.4. Mjetet dhe pajisjet

Bel, prashajkë, gërshtë, motokorse ,

VII. Vijëzimi i rrugëve

7.1 Volumet e punimeve

Ky shërbim konsiston në vijëzimin e rrugës kryesore me bojë biokomponente me gjerësi 15 cm për një gjatësi 820 ml në vit si dhe lysterjen me boje biokomponente dhe pastë te vendkalimeve te kembesoredhe dhe te bicikletave sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor për 226 m² në vit. Për këtë shërbim nevojitet një mjet për vijëzim rrugësh .

VIII. Heqja e mbeturinave inerte prane vend grumbullimeve te mbeturinave

8.1 Ky sherbim konsiston ne :

- a. Mirembajtjen dhe pastrimin gjate dites te mbetjeve ndertimore dhe te vellimshme te depozituara ne zonen e kontratuar, si dhe mbetjeve voluminoze (ambalazhe) qe tejmbushin artificialisht kontenieret dhe pengojne mbetjet e tjera urbane per t'u depozituar neper konteniere.
- b. Ky sherbim kryhet me ane te kamionave vetshkarkuese ose kamjioncinave vetshkarkuese
- c. Grafiket vjetor te punimeve per realizimin e ketij sherbimi pergatiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontratues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime sa here lind e nevojshme edhe brenda nje viti.
- d. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte :
 - 1. Oraret e operimit ne secilen pike kontenieresh
 - 2. Llojin , targon dhe itinerarin e makinave teknologjike qe do te kryejne sherbimin.
 - 3. Oraret e operimit dhe mjetet per sherbimet mbeshtetese.
 - 4. Numrin e puntoreve qe do te mbeshtetin cdo operacion punimesh.
- e. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit . Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- f. Autoriteti kontratues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe per kryerjen e sherbimeve te lartpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara , rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba per mospermbushjen e tyre.
- g. Per asnje rast nuk do te lejohen qe vendet e grumbullimit te mbeturinave te jene te papastruar nga mbetjet e mesiperme. Ne te gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktore te jashtem , operatori

i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga ora e njoftimit apo konstatimit të problemit. Në rast të kundërt përgjegësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen sipas parashikimit të sanksioneve të Ligjit Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbetjeve”.

- h. Operatori i shërbimit duhet të ketë cdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar dhe të deklarojë të makinerive, pajisjeve dhe puntorëve për kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.
- i. Neqoftesë gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rena gjatë transportit, ai do të përballë me penaltetet e parashikuara në përputhje me këto kontrata apo me gjatë të tjera sipas sanksioneve të ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- j. Përdorimi i uniformave për puntorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshem

8.2 Mjetet dhe pajisjet.

Operatori i shërbimit duhet të verë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi këto mjete dhe pajisje :

1. Vegla pune si lopata, fshesa për 2(dy) punonjës .
2. Automjetet të cilat do të përdoren për këtë shërbim do të jenë një fadromë dhe një kamion 5-10 ton, mund të kontrollohen në cdo kohë, por jo më pak se njëherë në gjashtë muaj, nga Autoriteti kontraktor për gjendjen e gatishmerisë dhe inventarizimin e tyre.
3. Cdo makineri për kryerjen e këtij shërbimi duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.
4. Të gjitha makinat për transportin e mbeturinave ndërtimore dhe të vëllimshme duhet të jenë të rregjistruara nga Autoriteti kontratues, të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjten ngjyrë.
5. Një listë e makinave për transportin e mbeturinave inerte dhe skeletike do t’i paraqitet Autoritetit Kontratues para fillimit të veprimtarisë së mesipërme.
6. Një sasi e konsiderueshme e pjeseve të ndërrimit të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

IX. Disponimi i ambientit për të realizuar shërbimin

- Në funksion të realizimit me cilësi të shërbimit duhet, që operatori i shërbimit të ketë në pronësi të tij apo me qira, një sipërfaqe jo më të vogël se 1000 m² të rrethuar dhe të përshtatshme për:
 - a. parkimin dhe riparimin e mjeteve objekt të shërbimit të kërkuar,
 - b. depozitimin e konteniereve rezerve
 - c. riparimin dhe larjen ditore të konteniereve
 - d. magazinimin e të gjitha veglave të punës, mallrave dhe cdo gjë tjetër që është e nevojshme për realizimin e suksesit të shërbimit.

X. Edukimi publik

- Me termin “Edukim Publik” do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i operatorit të shërbimit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbeturinave, fshirjes dhe larjes së rrugëve gjatë periudhës së kontratës .
 - Operatori i shërbimit duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarevajtjen e punës së operatorit të shërbimit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambientit.

Ky kontakt mund te realizohet si nepermjet masmediave ashtu dhe nepermjet shperndarjes se materialeve informuese mbi:

- a. mbledhja, perpunimi dhe largimi i mbeturinave,
- b. fshirja, larja speciale e rrugeve gjate periudhes se kontrates.
- c. edukata e hedhjes se mbeturinave ne vendin e caktuar